



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 03.08.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 27.07.2023, të parashtruar nga Grupi i Operatorëve ekonomik **NSHT "VIKTORY COM"; Company Eskavatori shpk; Marisa SH.P.K;** lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Ndërtimi i Rrugës X", Nr. i prokurimit- 632-23-397-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-003 - 511, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Grupi i Operatorëve ekonomik **NSHT "VIKTORY COM"; Company Eskavatori shpk; Marisa SH.P.K;** lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Ndërtimi i Rrugës X", Nr. i prokurimit- 632-23-397-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-003-511, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 24.07.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: **24.07.2023;**

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.27.07.2023, Grupi Operatorëve ekonomik **NSHT "VIKTORY COM"; Company Eskavatori shpk; Marisa SH.P.K;**, ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Ndërtimi i Rrugës X", Nr. i prokurimit- 632-23-397-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-003 -511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 03.08.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj ankimor në lidhje me eliminimin e ofertës tuaj janë të pabazuar, sepse nga ju nuk është plotësuar dhe dorëzuar Aneksi 7 i DT-ës, në të cilin shkruan: Ky Aneks është obligativ që të plotësohet dhe ti bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër që evidenton performimin e tillë. Ju nuk keni dorëzuar Aneksin 7 ashtu siç është kërkuar në DT.

Në lidhje me pretendimet tuaja ndaj GOE të rekomanduar për kontratë, ju njoftojmë se janë të pa qëndrueshme për shkak se GOE i rekomanduar për kontratë ka sejlle sqarime shtesë të cilat kanë qenë bindëse që oferta e tyre të jetë e përgjegjshme.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës